



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:260093

Datë: 14.12.2023

Numri i dokumentit: 05065327

**C-IV.-14-6291**

*Paditësi:*

**S B** nga Gjilani.

**Kundër**

*E paditura:*

**N.SH “Banka Themelore e Kosovës”,** të cilën e përfaqëson **Agjencia Kosovare e Privatizimit,** rruga “Dritan Hoxha”, Lakrishte, nr.55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.01 dhjetor 2023, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

**1. Procedura në këtë çështje juridike NDËRPRITET për shkak të vdekjes së ankuesit S B.**

**2. Procedura do të vazhdohet kur trashëgimtarët e të ndjerit kërkojnë vazhdimin e procedurës.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me dt.29 shtator 2014, ankuesi parashtrroi ankesë për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën prej vitit 2009 deri në vitin 1999, në shumë prej 35,188.016€ nga kundër N.SH “Banka Themelore e Kosovës”. Në ankesë kërkohet që gjykata të merr vendim me të cilin do të priset vendimi i AL PRN125-236 të dt.28.08.2014 dhe të Detyrohet NSH-ja që ushtruesit të

ankesës të ia kompensoj pagat e pa paguara me kamatë ligjore. Së bashku me ankesë kanë bashkëngjitur: Kopjen e vendimit të AL.

Me dt.19 shtator 2023, gjykata i dërgoj vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore për padi. Vërejtja është tentuar që ti dorëzohet dhe me dt.03 tetor 2023 postieri ka konstatuar “tentimi është bërë, pala ka vdekur”.

### **Arsyetimi ligjor**

Procedura në këtë çështje juridike ndërpritet për shkak të vdekjes së ankuesit.

Sipas nenit 76 par.3 të Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh: *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.”*

Kurse sipas dispozitës së nenit 277 pika (a) të LPK-së: *Procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale, e nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim.*

Ne vazhdim dispozita e nenit 280 par. 1 të LPK-së parasheh lidhur me Ligjin për ndryshime dhe plotësime Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore: *Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a)–d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore marrin përsipër procedurën .*

Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 277 pika (a) dhe nenit 280 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

### **Këshillë juridike**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r e  
**Hajrie Shala**